VENDIM
Nr. 54, datë 26.1.2015

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË MBËSHTETJES ME GRANTE NGA BUXHETI I SHTETIT NË SEKTORIN E SPORTIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 26.1.2015, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, nëpërmjet mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e dhënësit të ndihmës.

I. Procedura

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me shkresën nr. 6163, datë 21.8.2014, MZHETS i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e dhënësit të ndihmës, të njoftojë skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, të parashikuar në nenin 7 dhe 17 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 "Për sportin" i ndryshuar. Shoqatat sportive që kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, përfitojnë çdo vit nga buxheti i shtetit financime në formën e grantit dhe burimeve të tjera. MZHETS vlerësoi se aktivizimi i burimeve shtetërore në formën e grantit, në favor të organizatave të sportit në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet ekonomik, mund të përmbajë elemente të ndihmës shtetërore, dhe për të realizuar përputhshmërinë me ligjin e ndihmës shtetërore, skema duhet të njoftohej pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH).

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 6157/1, datë 15.10.2014, paraqiti informa-cionin e nevojshëm për vlerësimin e skemës ekzistuese të ndihmës shtetërore.

II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

a) Objektivi

3. Objektivi kryesor i skemës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport.

b) Baza ligjore

4. Baza ligjore e skemës është:

- ligji nr. 9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", i ndryshuar
- udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014 ""Për mënyrën e përdorimit të fondit "Grant/transfertë korrente e brendshme" për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar"".

c) Buxheti dhe mënyra e financimit

5. Ndihma jepet çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formën e grantit. Vlera totale e ndihmës për vitin 2014 është planifikuar 96,615,914 lekë.

d) Përfituesit

6. Përfituesit e skemës janë federatat e ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Federatat shqiptare të sportit janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, promovojnë, kontrollojnë dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtarë të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

7. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) ndikim në konkurrencë.

a) Burime shtetërore

8. Skema aktivizon burime shtetërore si rezultat i miratimit dhe shpërndarjes çdo vit të grantit nga buxheti i shtetit.

b) Ndërmarrja dhe avantazhi ekonomik

9. Sipas informacionit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, vetëm aktivitetet sportive të anëtarëve të federatave kombëtare të ndryshme të sportit kanë të drejtë të përfitojnë vlerën e grantit të akorduar nga buxheti i shtetit.

10. Referuar ligjit nr. 9376, datë 21.4.2014 "Për sportin", të ndryshuar, neni 30, pika 3 përcakton se:

"Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale".

Gjithashtu, neni 32 i ligjit për sportin, parashikon se :

"Organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutet e tyre".

Për më tepër, neni 34 i ligjit për sportin parashikon se:

"Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjedisive sportive, ku zhvillojnë veprimtarinë ose garën sportive, për reklamën e shoqërive të ndryshme tregtare, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese me to".

11. Sa më sipër, federatat e ndryshme sportive dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar do të konsiderohen ndërmarrje, për sa kohë që kryejnë një aktivitet ekonomik, si p.sh. shitja e biletave për evente sportive, shitja e të drejtës së transmetimit radioteleviziv apo nënshkrimi i marrëveshjeve të sponsorizimit ose reklamës.

12. Skema i jep një avantazh ekonomik përfituesve në organizimin e aktiviteteve sportive, sipas statutit të organizatave sportive, si rrjedhim lehtëson gjendjen financiare të tyre. Dhënësi i ndihmës ka vendosur kriteret kryesore për përfitimin e fondeve buxhetore nga ana e federatave shqiptare të sportit. Skema është selektive, por nuk trajton në mënyrë të diferencuar organizatat sportive me njëra-tjetrën.

13. Referuar udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014 ""Për mënyrën e përdorimit të fondit "Grant/transfertë korrente e brendshme" për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar"", zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi "Grant/tran-sfertë korrente e brendshme" për federatat shqiptare sportive përfshijnë dy kategori: 1. shpenzimet për pagat e dy punonjësve të federatave dhe shpenzime të tjera operative për funksionimin e veprimtarisë së federatave, dhe 2. shpenzime të tjera operative që kryejnë federatat për mbështetjen e sportistëve.

14. Referuar rasteve të ndihmës shtetërore të miratuara nga Komisioni Evropian[1], mbështetja me burime shtetërore për mbulimin e shpenzimeve të sportistëve profesionistë është objekt i rregullave të kontrollit të ndihmës shtetërore në shtetet anëtare të BE-së[2]. Ndërsa mbështetja me burime shtetërore e kostove të personelit dhe investimeve nga ana e federatave/klubeve sportive janë objekt i njoftimit dhe autorizimit të ndihmës shtetërore, në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet ekonomik.

15. Si rrjedhim, financimi me grant nga buxheti i shtetit[3] për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve nga ana e federatave kombëtare të sportit dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar është objekt i njoftimit dhe autorizimit të ndihmës shtetërore, në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet

[1] N118/2000 Subventions publiques aux clubs sportifs professionnels, France. SA. 31722 – Hungary Supporting the Hungarian sport sector via tax benefit scheme

[2] Bashkimit Evropian

[3] Sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014

ekonomik.

c) Ndikim në konkurrencë

16. Meqenëse konkurrenca mes federatave të ndryshme sportive në mënyrë të qartë është e shtrirë në nivel ndërkombëtar dhe shumë aktivitete kanë një përhapje dhe interes në vendet e rajonit/Evropës, masa e ndihmës shtetërore mund të ketë pasojë në konkurrencën. Për këtë arsye, mbështetja me fonde publike duhet të jetë në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian.

Konkluzion mbi ekzistencën e ndihmës shtetërore

17. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, përbën ndihmë shtetërore.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

18. Dhënia e ndihmës shtetërore ekzistuese është objekt i autorizimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, neni 8 "Ndihma "De minimis"", duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 20 (pika 3), 24, 25, 29, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë skemën ekzistuese në përputhje me kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti mbi vlerën totale të mbështetjes me grant nga buxheti i shtetit për:

- federatat e ndryshme të sportit – financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve;
- Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar – financimin për pjesën e kostos së mbuluar të personelit.

3. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ahmetaj